

Raporti i Monitorimit Qytetar të Zbatimit të Planit të Veprimit për Luftën kundër Korrupsionit për vitin 2011-2012

Metodologjia

Metodologjia e monitorimit është hartuar në përputhje të plotë me objektivat e kësaj nisme për të ofruar një monitorim të pavarur, objektiv dhe të paanshëm të zbatimit të Planit të Veprimit (PiV) të strategjisë anti-korrupsion. Më konkretisht, nëpërmjet vlerësimit të performancës në trajtimin e masave dhe objektivave të plan veprimit prej institucioneve, procesi i monitorimit synon të evidentojë jo vetëm progresin e këtyre institucioneve por edhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e masave të parashikuara në kuadër të luftës kundër korrupsionit nga këto ministri si dhe të japë rekomandime konkrete për përmirësimin e tyre. Nga pikëpamja kohore, monitorimi i PiV përfshin veprimtaritë e kryera nga qeveria (ose institucionet e tjera që zbatojnë planin e veprimit) në harkun kohor 2011 – 2012.

Përveç identifikimit të statusit të zbatimit për secilën masë të parashikuar në planin e veprimit, ky monitorim është fokusuar edhe në cilësinë e formulimit të planit të veprimit duke ndjekur kështu një qëllim të dyfishtë: nga njëra anë është përpjekur të informojë në lidhje me zbatimin ose jo të masave, dhe nga ana tjetër, të identifikojë probleme në formulimin e planit të veprimit.

Më konkretisht, raporti i monitorimit të PiV, përveç identifikimit të statusit të secilës masë (pra zbatuar apo jo) sjell informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Përshtatshmëria e masave në raport me objektivat;
2. Përshtatshmëria e ndarjes së përgjegjësive për zbatimin e masave;
3. Përshtatshmëria e afateve kohore për zbatimin e masave;
4. Përshtatshmëria e burimeve të vëna në dispozicion për zbatimin e masave; dhe
5. Përshtatshmëria e treguesve të realizimit.

Sa i takon përshtatshmërisë së masave në raport me objektivat e luftës kundër korrupsionit (pika 1), raporti i monitorimit informon në lidhje me disa nënçështje të rëndësishme. Kështu, p.sh., në raport jepen vlerësime në lidhje me qartësinë e formulimit të secilit prej objektivave. Së dyti, bëhet një vlerësim nëse objektivi ka lidhje me luftën kundër korrupsionit.

Vlerësimi i tretë ka të bëjë me atë se sa konkrete është masa në fjalë. Së katërti, raporti i këtij monitorimi informon edhe sesa të përshtatshme janë masat e parashikuara në Planin e Integruar të Veprimit për arritjen e objektivave të shpallur nga qeveria.

Në lidhje me përshtatshmërinë e alokimit të përgjegjësive për zbatimin e masave (pika 2), raporti i monitorimit përmban vlerësime të rëndësishme në lidhje me nënçështje, të tilla si qartësia në ndarjen e përgjegjësive për zbatimin e masave, nëse ndarja e përgjegjësive është bërë në nivelin e duhur, nëse është identifikuar qartë institucioni që ka përgjegjësi kryesore për zbatimin (në ato raste kur plani i veprimit identifikon më shumë se një institucion përgjegjës), etj.

Një tjetër aspekt që trajtohet nga raporti i monitorimit është përshtatshmëria e afateve kohore për zbatimin e masave (pika 3) duke vlerësuar respektimin e afateve të zbatimit të masave dhe përshtatshmërinë e tyre.

Sa i takon përshtatshmërisë së burimeve të vëna në dispozicion për zbatimin e PiV nga qeveria (ose institucionet e tjera që zbatojnë planin) (pika 4) raporti i monitorimit ka identifikuar dhe raportuar për të gjitha ato raste kur PiV nuk parashikon burime, kur burimi nuk është mjaftueshëm i specifikuar dhe kur nuk parashikohet kostoja e nevojshme për realizimin e masës.

Së fundi, për secilën nga masat e parashikuara në PiV raporti informon në lidhje me përshtatshmërinë e treguesve të realizimit (pika 5) dhe mjaftueshmërinë e tyre për të treguar ecurinë e zbatimit.

Informacioni i nevojshëm për hartimin e këtij raporti monitorimi është siguruar përmes kërkesave zyrtare për informacion, intervistave, konsultimeve të faqeve përkatëse të internetit, kuadrit ligjor dhe të politikave në fuqi, raporteve të ndryshme dhe burimeve të tjera zyrtare informacioni.